



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1508, datë 10.02.2011**

**Për**

**“Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

|                |            |         |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro     | Xhixho     | Kryetar |
| 2. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar  |
| 3. Z. Benon    | Paloka     | Anëtar  |
| 4. Z. Ibsen    | Elezi      | Anëtar  |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe      | Anëtar  |

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.02.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a”

Dokumentacioni i Grupit të Punës të ngritur me Urdhërin e Brendshëm nr. 639, datë 15.11.2010, përbëhet nga:

- Projekt vendimi;
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit;

## BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 53, 55, 56, 57, 58 dhe 59 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1212, datë 31.03.2010, i ndryshuar.
4. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1505, datë 10.02.2011“Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT”

## K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Projektvendim i KD të AKEP “Miratimin e metodologjisë së rregullimit për orientimin në kosto të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit EM sh.a”
2. Relacioni shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*), si dhe,
3. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP nr.1505, datë 10.02.2011, “Miratimin e Dokumentacionit Final: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT” së bashku me dokumentacionin shoqërues të këtij Vendimi.
4. Nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar.

## V Ë R E N:

1. Bazuar në VKD nr. 1212, datë 31.3.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit EM sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, i ndryshuar, dhe në rezultatet finale të modelit BULRAIC të kostove të telefonisë së lëvizshme, AKEP më 29.12.2010-29.01.2010, kreu këshillim publik të dokumentit: Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT.
2. Proçesi i këshillimit publik përfshinte midis të tjerave këshillimin për orientimin në kosto të tarifës së shërbimit me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetin celular EM, për të cilin EM është shpallur me FNT me vendimin nr.1212, datë 31.03.2010, i ndryshuar, dhe për të cilin është vendosur detyrimi për orientim në kosto të tarifës së ofrimit të tij.

3. EM sh.a. nëpërmjet shkresës Nr. 321 Prot, datë 28.01.2011, ka dhënë komente për dokumentin e nxjerrë në konsultim publik.
4. Me vendimin nr.1505, datë 10.02.2011, AKEP miratoi dokumentin final për *Orientimin në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT*, si dhe qëndrimet ndaj komenteve të palëve të interesuara, përfshirë komentet e EM.
5. Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetin EM, të përcaktuar në dokumentin *Orientimi në kosto i tarifave të shërbimeve të operatorëve celularë me FNT-Dokumenti Final*, i miratuar me VKD nr.1505, datë 10.02.2011:
  - a. Bazohet në rezultatet e modelit BU- LRAIC (Bottom- Up Long Run Average Incremental Cost) për përcaktimin e kostove të ofrimit eficient të shërbimeve të operatorëve të telefonisë së lëvizëshme që operojnë në një treg konkurrues në Shqipëri, të realizuar nga kompania konsulente nderkombëtare ICC.
  - b. Përbëjnë një implementim të detyrimit të orientimit në kosto të ofrimit eficient sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918.
  - c. Përbëjnë reduktim të përshkallëzuar të tarifave të EM deri në nivelin e kostos së ofrimit eficient të tyre sipas rezultateve të modelit të kostove BULRAIC, duke realizuar në të njëjtën kohe konvergencën e tarifave të terminimit në rrjetet e katër operatorëve celularë aktivë në Shqipëri, dhe është në përputhje me rekomandimet e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore për orientimin në kosto të tarifave të shërbimeve të operatorëve me FNT;
  - d. Lejon sipërmarrësin të marrë një normë të arsyeshme fitimi për investimin e kryer dhe nivelin e riskut për shërbimet me shumicë të terminimit dhe origjinimit të thirrjeve, dhe përmban një afat kohor të arsyeshëm (reduktim i përshkallëzuar) për orientimin në kosto të tarifave;
6. Implementimi i detyrimit të orientimit në kosto të tarifave me shumicë të terminimit të thirrjeve për EM, dhe për lojtarët e tjerë në treg sipas detyrimeve respektive, i shërben realizimit të objektivave rregullatore të nenit 7 të ligjit nr. 9918 për nxitjen e konkurrencës eficiente midis lojtarëve në treg dhe rritjen e përfitimeve të përdoruesve fundorë nga përdorimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të këtij dokumenti për konkurrencën në treg, sipërmarrësin dhe realizimin e objektivave rregullatore, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

## V E N D O S:

1. Të miratojë metodologjinë e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a., për orientimin në koston e ofrimit eficient të këtyre shërbimeve sipas përcaktimeve në dokumentin bashkëngjitur këtij vendimi në Aneks nr.1: *Metodologji e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të sipërmarrësit Eagle Mobile sh.a.*
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Eagle Mobile sh.a dhe palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ për këtë vendim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**

**Piro XHIXHO**

### **ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**

## ANEKS 1:

### METODOLOGJI E RREGULLIMIT TE TARIFËS SË TERMINIMIT TË THIRRJEVE NË RRJETIN PUBLIK TELEFONIK TË LËVIZSHEM TË SIPËRMARRËSIT EAGLE MOBILE SH.A.

1. Objekt i rregullimit të kësaj metodlogjie është tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të EM:
2. Metoda e rregullimit të tarifës së terminimit të thirrjeve është përcaktimi i nivelit maksimal, në secilën periudhë rregullimi, sipas pikës 1/a të nenit 57 të Ligjit 9918.
3. Vlerat maksimale të tarifës së terminimit të thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm të EM, për t'u aplikuar nga EM sh.a sipas periudhave përkatëse paraqiten në Tabelën nr.1 më poshtë:

**Tabela 1: Vlerat maksimale të tarifës së terminimit në rrjetin EM (lek/minutë)**

|                         | <b>1.03.2011-<br/>31.08.2011</b> | <b>1.09.2011-<br/>31.08.2012</b> | <b>1.09.2012-<br/>31.08.2013</b> | <b>1.09.2013-</b> |
|-------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|-------------------|
| <b>Tarifa maksimale</b> | <b>10.89</b>                     | <b>8.85</b>                      | <b>6.52</b>                      | <b>4.57</b>       |

*Shënim: TVSH nuk është përfshirë.*

4. Niveli i tarifave të mësipërme për shërbimin e terminimit të thirrjeve është i aplikueshëm për shërbimet për të cilat EM ka status me FNT dhe që ka detyrim për orientim në kosto sipas përcaktimeve të VKD nr.1212, datë 31.03.2010, i ndryshuar, apo vendimeve të tjera që mund të merren për këtë status dhe detyrimeve për FNT sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 9918. Përcaktimet e nenit 34 të ligjit 9918 do të aplikohen edhe në rastet e ndryshimit të detyrimeve apo revokimit të statusit me FNT dhe detyrimeve për këtë status.